

ReMusica
PRISHTINA INTERNATIONAL FESTIVAL
23-28 Maj 2017



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS
REMUSICA 2017

Tel.: + 386 (0)49622260

Address: Kroi Bardhë D-V / 9 10000 Prishtinë KOSOVA

www.remusicafestival.com



16th
edition
www.remusicafestival.com

EDITORIAL

Edicioni i 16 i ReMusica-s vazhdon rrugëtimin duke i qëndruar besnike fizionomisë saj të përhershme, duke sjellë rryma të ndryshme stilistike. Një ndër shtyllat kryesore të këtij viti është fokusi në muzikën vokale dhe muzikën e vjetër e cila konsiderojmë është shumë e pakët dhe pothuajse tërësisht nën hije dhe jashtë fokusit të skenave tona muzikore. Megjithatë, vend të veçantë në ReMusica sivjet do zë koncerti “**Jehonë Barokiene**” i shtatë artistëve tanë të rinj, të nxitur nga Safet Berisha dhe Kaltrina Miftari, artistë që po dallohen me përkushtimin e tyre në kultivimin e këtij zhanëri të veçantë dhe specifik.

Gjithsesi, prestigjin e edicionit të sivjemë e ruajnë dy solistët e shkëlqyeshëm: kornisti çek **Premysl Vojta** i cili është fitues i shumë çmimeve të ndryshme ndërkombëtare, ndër to çmimi i Parë në garën Ndërkombëtare ARD (gara ndërkombëtare e muzikës klasike me e rëndësishme në Gjermani). Vojta përpos recitalit të tij, do ta mbyllë këtë Edicion të ReMusica-s në koncertin bashkëpunim me Orkestrën Simfonike të Filharmonisë së Kosovës. Violinist **Kristi Gjezi**, fitues i shumë çmimeve ndërkombëtare dhe violinist i parë i Orkestrës Filharmonike të Monte Karlos, do të vie në bashkëpunim me Korin e Filharmonisë së Kosovës me dirigjent Rafet Rudin. Kori i Filharmonisë sivjet paraqitet me program a capella, ku dominojnë veprat moderne të kompozitorëve të rinj kosovarë, deri te vepra e kompozitorit Rudi në bashkëpunim me violinistin Gjezi.

Risi e Festivalit ReMusica këtë vit është bashkëpunimi me teatrin muzikor “**Via Berlin**” të cilët dëshmojnë se teksti, muzika, aktori dhe muzicienti, mund të jenë mjete thelbësisht të barabarta në një realizim skenik. Teksti thjesht ofron skicën e storjes, lokacionin dhe karakteret, përderisa imazhet dhe muzika plotësojnë pjesën e mbetur. Shfaqja muzikore “**Breaking the Silence**” do të vjen për publikun kosovar në një formë ende të padëgjuar dhe paparë tek ne, nën e interpretimin e kuartetit shumë të çmuar të saksofonëve nga Amsterdami “**Berlage Saxophone Quartett**”, të cilët përpos çmimeve të para në Selmer Saxophonquartett Wettbewerb, Chamber Music Competition të Storioni Festival, apo çmimi prestigjioz Kersjes Prijs në Concertgebouw në Amsterdam, ansambli mblodhi rreth vetës publikë nëpërmjet entuziazmit infektues të tyre, sharmin natyral dhe muzikalitetin intensiv të performancave të tyre. Në këtë Edicion të ReMusica-s do të ketë një numër të madh të premierave të kompozitorëve kosovar, kjo edhe është karakteristika e përhershme e Festivalit, që arrinë ta stimuloj dhe vë në pah krijimtarinë vendore.

Koncertet e përvitshme të ReMusica-s, si nata dedikuar muzikës akusmatike dhe programit të fëmijëve ReMusica Junior (Bota e tingujve) nuk do të mungojnë. Si gjithmonë, përpos aktiviteteve koncertale, në kuadër të Festivalit do të realizohen një mori masterkursesh, punëtori dhe Tribuna Muzikologjike / Debat mbi “Kritikën muzikore sot”, me të ftuarit e medimeve shqiptare Kosovë- Shqipëri.

Drejtoreshë e Festivalit
Donika Rudi



23 MAJ, e martë

Hapja/Opening

20:00 Kisha Katolike Shën Ndou

KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS

Kristi GJEZI violinë | Rafet RUDI dirigjent

24 MAJ, e mërkurë

12:00 Akademia e Muzikës

Tribunë Muzikologjike: Debat “ Kritik muzikore sot”

20:00 Kisha Katolike Shën Ndou

RECITAL KRISTI GJEZI violinë

Merita Rexha Tërshana piano

21:00 Kisha Katolike Shën Ndou

JEHONE BAROKIENE

25 MAJ, e enjte

12:00 Qendra Multimedia

ReMusica Junior - Bota e tingujve

vepra akusmatike per fëmijë

20:00 Qendra Multimedia

NATA AKUSMATIKE BELGE / BELGIAN ACOUSMATIC NIGHT

Rafael Munoz GOMEZ spacializues

26 MAJ, e premte

20:00 Qendra Multimedia

NATA HOLANDEZE / DUTCH NIGHT

Koprodukcion Muzikë Teatër - BREAKING THE SILENCE

Kuarteti i saksofonëve “Berlage Saxophone Quartett” & Teatri “Via Berlin”

Lars Niederstraßer / Peter Vigh/ Juani Palop / David Cristobal Litago.

27 MAJ, e shtunë

20:00 Kisha Katolike Shën Ndou

RECITAL Premysl VOJTA kornë | Merita Rexha Tërshana piano

21:00 Kisha Katolike Shën Ndou

SKENA E RE

ANSAMBLI ATTACCA | Hajrullah SYLA dirigjent

28 MAJ, e diel

20:00 Atelieja e Pallatit të Rinisë

ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS

Premysl VOJTA kornë | Fernando BRIONES dirigjent



Hapja/Opening

20:00 Kisha Katolike Shën Ndou

KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS

Kristi GJEZI violinë
Rafet RUDI dirigjent

Memli Kelmendi

Ater Umbra

Vinçenc Gjini

Lutje

Leonard Bernstein

America

Fjolla Gashi *soprano* | Diellza Sylejmani *alt*

Rafet Rudi

Concerto Fantasy *për violinë dhe kor*

Kristi Gjezi violinë

Baki Jashari

Pakëz në ëndërr, pakëz në zhgëndërr

Çun Lajçi recitator

Veljo Tormis

Curse Upon Iron

Words after the Finnish national epic "Kalevala"

Liridon Sadriu tenor | Endrit Rexhepi bariton

Solistë :

Liridon Sadriu tenor | Adelina Paloja soprano | Kaltrina Miftari soprano
Artemida Qarri piano | Patris Berisha perkusione

Koncert në bashkëpunim me Filharmoninë e Kosovës.



Kori i Filharmonisë së Kosovës është ansambël profesional (me 50 antarë profesionist) i cili vazhdon punën e Korit profesional të ish Radio-televizionit të Prishtinës, kor i cili veproi me shumë sukses që nga viti 1980 nën drejtimin e dirigjentit R.Rudi. Me aktivitetin e tij, Kori i Filharmonisë gjithashtu vazhdon të kultivojë traditën e këndimit koral që në Kosovë ekziston që nga viti 1945. Programi i këtij ansambli përfshin vepra të një game të gjërë stilistike, duke filluar nga veprat e mjeshtërve të vjetër (G.P.Palestrina, C.Monterverdi, Th.L.de Victoria, J.S.Bach) e deri te veprat e kompozitorëve të rëndësishëm të literaturës nga literatura moderne korale (B.Britten, G.Ligeti, A.Pärt, E.Whitacre etj.). Vend të rëndësishëm në programet e Korit zë krijimtaria e kompozitorëve kosovarë/shqiptarë.

Vitet e fundit, Kori i përkushtohet realizimit të një mori veprash të rëndësishme vokalo-instrumentale si: 'Vespro della Beata Virgine 1610', Kantata Nr. 28 e J. S. Bahut, Gloria e Vivaldit, Missa D-dur e W. A. Mozartit, Mesha për paqe 'The Armed Man' e kompozitorit bashkëkohor anglez Karl Jenkins etj. Në realizimin e programeve a capella si dhe veprave të mëdha vokalo-instrumentale, me Kor dirigjuan edhe Baki Jashari, dirigjentët sloven. Falë angazhimit të dirigjentit dhe kompozitorit R.Rudit, Kori është i angazhuar në zbulimin, restaurimin dhe adaptimin e literaturës korale të autorëve të vjetër, që kanë prejardhje nga këto troje. Veprat e Gjergj Danush Llapacaj, Jan Kukuzelit dhe Niketë Dardanit (i Remisianës), për herë të parë bëhen pjesë e repertorit standard koral tek ne.

Dirigjent permanent i Korit është Rafet Rudi.

Filharmonia e Kosovës, me aktivitetin e dy njësisve të saj, Korit dhe Orkestrës simfonike paraqet boshtin kryesor, rreth të cilës frymon jeta muzikore në Kosovë.

Rafet RUDI (1949) Studimet i kreu pranë Akademisë së Muzikës në Beograd, ku diplomoi në degën e dirigjimit dhe kompozimit. Mbaroi studimet pasuniversitare, kurse specializoi në Konservatorin Nacional të Parisit në klasën e kompozitorit Claude Ballif. Në periudhën 1980 - 1987 ishte dirigjent permanent i Korit profesional të RTV të Prishtinës. Merrtet me publicistikë dhe ka mbi 400 shkrime të ndryshme (eseistikë, recensione, kritikë etj.). Të botuar ka disa libra shkollorë, si dhe librin teorik "Sprova estetike." Është themelues i Qendrës Kosovare për Muzikën e Re dhe themelues i Festivalit ndërkombëtar të Prishtinës - ReMusica.

Rudi është laureat i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve të rëndësishme: Çmimi i Dhjetorit të Kosovës për krijimtari; Çmimi i Festivalit Ndërkombëtar BEMUS etj. Veprat kryesore: Simfonia, Kohë koncertante për piano dhe orkestër simfonik, Koncert për kitarë dhe orkestër harkor, 'The return' për mexosoprano dhe orkestër simfonik etj. Veprat i janë botuar në Francë dhe në Gjermani përderisa ato i luhen në shumë vende të botës.

Rudi është dirigjent permanent i Korit të Filharmonisë që nga viti 2006. Në drejtimin e tij, Kori dhe Orkestra e Filharmonisë, realizojnë një mori veprash të rëndësishme vokalo-instrumentale si: Missa D-dur e Mozartit, 'Vespro della Beata Virgine 1610' e Monteverdit etj. Në vitet e fundit, Rudi i përkushtohet zbulimit, restaurimit dhe adaptimit të literaturës korale të autorëve të vjetër shqiptarë. Rudi, është anëtar i rregullt i Akademisë Europiane të Arteve dhe anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave

20:00 Kisha Katolike “Shën Ndou”

RECITAL KRISTI GJEZI violinë

Merita Rexha Tërshana piano

Pjetër Gaçi

Ballade

J.S. Bach

Violin Partita No.3 in E major, BWV 1006

për violinë solo

Sergei Prokofiev

Violin sonata n°1

Camille Saint-Saëns

Rondo Capriccioso



Kristi GJEZI filloi ushtrimet në violin me babanë e tij Spiro Gjezi. Pas studimeve në Konservatorin e Bordosë, në moshën 13 vjeçare ju bashkua Conservatoires Nationaux Supérieurs de musique et de danse (CNSMD), në klasën e Patrice Fontanarosa.

Më 2005 Kristi Gjezi fitoi vendin e Parë në Garën Ndërkombëtare të violinës në Avinjon (Francë ndërsa më 2007 diplomoi me merita të larta dhe më vonë ju bashkua kurseve të avancuara të Jean Jacques Kantorow dhe Svetlin Roussev.

Në vitin 2008, Kristi zuri vendin e tretë në Garën prestigjioze Ndërkombëtare të violinës “Tibor Varga” në Sion (Zvicër). Në vitin 2009 zuri vendin e dytë, kësaj rradhe në Garën “Pablo de Sarasate” në Pamplona (Spanjë) dhe më 2013 në Garën e V-të Ndërkombëtare “David Oistrakh” në Moskë.

Kristi është i rregullt në festivale dhe skenën klasike në Francë, në ngjarjet si Orangerie Bagatelles, Autumn Music Festival, Petit Palais, etj. Ai poashtu ka performuar në Europë, në vendet si Zvicra, Spanja, Franca, Bullgaria dhe si solist me Orkestrën Filharmonike të Cyrihut, Orkestrën Padeloup, Orkestrën Operistike të Marsejës etj.

Gjezi është mysafir i rregullt në France Musique, në emisionet si Gaelle Legallie “Dans la Cour des Grands”. Kristi Gjezi ka gjetë mbështetjen e Natexis Banque Populaire Foundation dhe pranoi violinë G.B. Guadagnini të vitit 1784, të huazuar nga Zilber Foundation nga viti 2007 deri më 2009.

Momentalisht, Kristi Gjezi është violinist i Parë solo i Orkestrës Filharmonike të Monte Karlos. Ai performon në J.B. Vuillaume të huazuar nga një donator anonim.

Merita Rexha TERSHANA është një nga pianistet më aktive në skenën muzikore shqiptare. Ajo përfundoi studimet e larta në klasën e prof. Margarita Kristidhi në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas ka ndjekur disa kurse pasuniversitare në Gjermani me profesorë të njohur si Paul Badura-Skoda, Till Engel, etj. Ka luajtur si soliste me orkestrat e Radio Television Shqiptar, Teatrit të Operas e Baletit, Filarmoninë e Tiranës dhe Kosovës etj. Ka marrë pjesë e ftuar në festival prestigjioze si soliste dhe në asamble të muzikës së dhomës, si në Schleswig Holstein Musik Festival në Gjermani, Bregenz Festspiel në Austri, etj. Është e ftuar prej shumë vitesh në festivalet më prestigjioze të rajonit si në Festivalin ReMusica në Kosovë, Ohrid Summer Festival, Pianodrom, Festivalin ndërkombëtar I muzikës së dhomës dhe vitin e fundit në Different trains Festival dhe Ballkan contemporary music festival. Ka interpretuar në vende të ndryshme si Gjermani, Austri, Japoni, Danimarkë, Zvicër, Itali, Greqi, Maqedoni, etj. Ka bashkëpunuar me instrumentistë të njohur si Klaidi Sahatçi, Ermir Abeshi, Areta Zhulla, Thomas Leleu etj. Në vitin 2009 ka regjistruar një cd me vepra të Schumann-it. Në Shqipëri është fituese e shume çmimeve, ndër to fituese dy herë e çmimit Kult si Interpretuesja më e mirë e vitit. Punon në Universitetin e Arteve në Tiranë dhe që nga si pedagoge në Katedrën e Pianos. Ka titullin Profesor I Asociuar që prej vitit 2007.



21:00 Kisha Katolike Shën Ndou

JEHONE BAROKIENE

Kaltrina Miftari | Safet Berisha

Diellza Sylejmani | Shaban Behramaj |
Granit Musliu | Pranvera Hoxha | Adorel Haxhijaj

Giovanni Battista Pergolesi

Stabat Mater

Giovanni Battista Pergolesi

Fac ut portem (pjesë nga Stabat Mater)

Barbara Strozzi

Lagrima mie

Gilles Binchois

Triste plaisir

Henry Purcell

Thy hand, Belinda... When I am laid

Giovanni Legrenzi

Lumi Potete Piangere

Kaltrina Miftari soprano | Safet Berisha kontratenor
Pranvera Hoxha cemballo/harmonium | Adorel Haxhijaj cello

Anonym

Din dirin din

Thomas Tallis

If ye love me

John Tavener

The Lamb

William Byrd

Ave verum corpus

Traditional

Irish Blessing

John Dowland

Come Again

Thomas Morley

Now is the month of maying

Kaltrina Miftari soprano | Diellza Sylejmani alto | Safet Berisha tenor |
Shaban Behramaj bas | Granit Musliu tenor

JEHONE BAROKIENE Programi dhe emrat pjesmarrës në koncertin tematik 'Jehonë Barokiene', dëshmojnë një nivel të konsiderueshëm artistik të plejadës së re të artistëve tanë. Gjithsesi e dallueshme është tendenca e tyre për përkushtim më të thelluar në një zhanër të veçantë dhe specifik.

Kaltrina Miftari dhe Safet Berisha, si ideator dhe sajues të këtij koncerti, gjithnjë e më shumë shquhen në këtë tendencë. Ata janë duke e formuar profilin e tyre artistik, si bartës kryesor të kësaj rruge. Interesimi i tyre i shfaqur vite më pare për kultivimin e muzikës barokiene, gjithnjë e më shumë po merr formë të përcaktuar ndaj muzikës së mjeshtërive të vjetër. Këtyre dy artistëve tanë, në këtë koncert po i bashkangjiten miqtë e tyre, artistët Diellza Sylemani, Shaban Behramaj, Adorel Haxhijaj, Pranvera Hoxha, dhe Granit Musliu duke shquar dhe pasuruar edhe më shumë këtë tendencë.



12:00 Qendra Multimedia
ReMusica Junior - Bota e tingujve
vepra akusmatike per fëmijë

20:00 Qendra Multimedia
NATA AKUSMATIKE BELGE / BELGIAN ACOUSMATIC NIGHT
Rafael Munoz GOMEZ spacializues

Jean Baptiste Zellal

Ruines

Laurent Delforge

Avant les tigres

Roeland Luyten

Darker

Rafael Munoz Gomez

Ribambelle de Ritournelles

Rafael Munoz GOMEZ kreu studimet ne Konservatorin Mbretëror të Monsit (Conservatoire Royal de Mons) në klasën e Annette Vande Gorne. Gomez është i dhënë pas muzikës repetitive, ritmit, tipareve tingullore dhe studimeve thelbësore të tyre. Sot është i përkushtuar që baza e kompozimeve të tija të jetë një gërshetim në mes këtyre elementeve.

Performoi në skena të ndryshme eksperimentale dhe festival të rëndësishme, siç janë: Festival Transnumériques, City Sonic, Festival Résonances, Museum Night Fever në La Monnaie, në My Mudam days të MUDAM, muzeun e Artit Modern në Luksemburg, La Nuit Blanche në Bruksel në Teatrin e vjetër Marivaux.

Në prill të vitit 2014 fitoi çmimin për kompozimin më të mirë Filmik, në Edicionin e 30 të Festival du Cinéma Européen de Lille, për filmin e metrazhit të shkurtë “Welkom” të Pablo Munoz Gomez.

Në prill të vitit 2016 themeloi kolektivin ON. nëpërmjet të cilit organizohen performanca muzikore në hapsirat e ndryshme të Brukselit.

Qe nga janari i 2014, Rafaeli është përgjegjës për Akosmoniumin e institucionit Musiques et Recherches në Belgjikë.

Presented by:



KINGDOM OF BELGIUM
www.diplomatie.belgium.be



20:00 Qendra Multimedia

NATA HOLANDEZE / DUTCH NIGHT

Koprodukcion Muzikë Teatër - BREAKING THE SILENCE

Kuarteti i saksofonëve “Berlage Saxophone Quartett” & Teatri “Via Berlin”

Lars Niederstraßer / Peter Vigh/ Juani Palop / David Cristobal Litago.

Via Berlin prezanton 'Breaking the Silence' (Thyerja e Heshtjes), një projekt në bashkëpunim me Berlage Saxophone Quartet. Breaking the Silence zbulon tensionin mes lirisë dhe sigurisë, aventurës dhe sigurisë, artit dhe shtetit, në një tregim dashurie që merr formë në mes të diktaturës.

Performanca muzikore përmbanë veprat e Shostakovich dhe Ligeti, të cilat janë shkruar nën kthetrat e totalitarizmit. Muzika shfaqet si pjesë integrale e produktionit teatral dhe është përshtatë për kuartet saksofonësh. Për më tepër, produksioni përmbanë kompozime origjinale të altos residente të Berlage Saxophone Quartet, Peter Vigh. Këto kompozime do të paraqiten mes pjesëve të kompozitorëve klasik.

Presented by:



Kingdom of the Netherlands

BERLAGE SAXOPHONE QUARTETT u formua në Amsterdam në vitin 2008 nga Lars Niederstraßer, Peter Vigh, Kirstin Niederstraßer dhe Eva van Grinsven. Kuarteti së bashku studioi muzikën e dhomës me Artemis Quartett në Berlin dhe ndjekën master kurset në ansambël, duke performuar me pjesëtarët e Alban Berg Quartett dhe Belcea Quartet. Katër muzicentët e rinjë shpejt krijuan emër të vetin si kuartet, duke fituar çmime të shumta në gara, siç janë çmimet e para në Selmer Saxophonquartett Wettbewerb, Chamber Music Competition të Storioni Festival, çmimin e parë dhe çmimin e Publikut në garën ndërkombëtare OnWings! Ansambli mbledhi rreth vetës publikë nëpërmjet entuziazmit infektues të tyre, sharmin natyral dhe muzikalitetin intensiv të performancave të tyre.

Në Deutsche Musikwettbewerb 2011 në Berlin, Berlage Saxophone Quartet fitoi bursë për performancën e realizuar dhe u përfshinë në sezonin 2012/2013 të Concerts by Young Artists në edicionin e 56 të kësaj ngjarjeje të Gjermanisë.

Në krye të kësaj, ata fituan çmime në garën prestigjioze të Dutch Classical Talent Award 2013, çmimin e Jurisë dhe të Publikut, në Concertgebouw Amsterdam, dhe si rrjedhojë edhe turin në sallat koncertale kryesore të Holandës. Në vitin 2015, kuarteti fitoi çmimin prestigjioz Kersjes Prijs për Muzikë Dhome në Concertgebouw në Amsterdam.

Ata ftohen në koncerte ndërkombëtare, si dhe performanca në radio dhe televizion, në kanalet si Deutschlandfunk, NDR dhe Radio 4 (Holandë). CD-ja debutante e ansambllit, e quajtur SaxoFOLK dhe e publikuar në 2014 me MDG, u vlerësua lartë nga shtypi muzikor ndërkombëtar.

“Via Berlin” Çka ndodhë kur përdor muzikën klasike si përbërës bazë për kompozimin e tregimit të shkruar me tema shoqërore dhe e gjithë kjo ndodhë në një ambient teatral? Do ishte e vështirë të imagjinohej, por mu kjo është ajo çka Via Berlin bën.

Via Berlin është teatër muzikor Holandez, i krijuar në vitin 2008. Që atëherë, Via Berlin arriti të shfaqë gjashtë produksione për mbi 35,000 shikues dhe janë shëndruar në kompani të pavarur. Për Via Berlin teksti dhe muzika, si dhe aktori dhe muzicenti, janë mjete thelbësisht të barabarta në realizimin e tregimit. Linja e vazhdueshme muzikore (klasike) ekziston përgjatë performancës dhe shpesh muzika luan rolin kryesor. Teksti thjesht ofron skicën e storjes, lokacionin dhe karakterët; imazhet dhe muzika plotësojnë pjesën e mbetur.

Të gjithë performuesit skenik janë aktorë dhe muzicent. Kjo mënyrë e punës krijon unitet të fortë dhe shkrirje organike mes dy disiplinave, duke pasë kujdes në ruajtjen e kualitetit individual të performuesve. Krijimin e performancës muzikore teatrale, rreth një teme të caktuar, me përdorim të muzikës klasike si treguesin kryesor të tregimit, në kombinim me tekstin, paraqet karakter unik në Holandë dhe më gjerë.

Duke trajtuar tema shoqërore si 'lufta', apo 'imigrantët ilegal', shfaqjet e Via Berlin paraqesin tregime intime dhe personale, që simbolizojnë ngjarje univerzale. Triologjia e Via Berlin mbi luftën është shpërblyer me çmimin Dutch Charlotte Kohler.



20:00 Kisha Katolike "Shën Ndou"

RECITAL PREMYSL VOJTA kornë

Merita Rexha Tërshana piano

Ludwig van Beethoven

Sonata for Piano and French Horn, op. 17 J.S.

Allegro moderato / Poco Adagio

Quasi Andante / Rondo / Allegro moderato

Robert Schumann

Fantasiestücke

Olivier Messiaen

Interstellaire

për kornë solo

Gilbert Vinter

Hunter's Moon for

French Horn

Franz Strauss:

Nocturno, Op. 7

Premysl VOJTA është fitues i shumë çmimeve të ndryshme ndërkombëtare. Ai fitoi çmimin e Parë në garën Ndërkombëtare ARD (gara ndërkombëtare e muzikës klasike me e rëndësishme në Gjermani) më 2010. Poashtu pranoi çmimin e Publikut dhe çmimin për Performancën më të mirë për vepër të re ashtu si dhe çmimin e veçantë nga New Philharmonie Westfalen. Në vitin 2011, pas debutimit të suksesshëm në Beethoven Festival Bonn, pranoi çmimin prestigjioz Beethoven Ring.

Premysli lindi më 1983 në Brno (Republika Çeke), ndërsa ushtrimet në korno nisi në moshën dhjetë vjeçare nën mbiqyrjen e Olga Voldánová. Pas studimeve në Konservatorin e Pragës me Bedřich Tylšar, u shpërngul në Gjermani ku ishte student i Christian-Friederich Dallmann në Universitët der Künste Berlin, nga viti 2004 gjer më 2010.

Tani është ligjerues në Hochschule für Musik und Tanz të Kolnit. Aktualisht është i angazhuar si solist në Akademinë e St Martin në Fields, në Radion e Orkestrës Simfonike Bavareze, Radio Orkestrën e Shtutgartit, në Orkestrën Konzerthaus të Berlinit, Orkestrën shtetërore të Wiesbaden dhe Filharmoninë e Pragës. Performoi në recitale dhe solo koncerte në festivale Europiane me nëm, përfshirë këtu Beethoven Festival në Bon, Prague Spring, Festivalin Mitte Europa dhe Mount Olympus Festival në Shën Petersburg.

Si student Premysl Vojta ishte anëtar i Orkestrës Rinore Gustav Mahler dhe Orkestrës Rinore të Bashkimit Europian, si dhe performoi me Filharmoninë e Pragës. Kishte pozitën e kornistit të parë në Staatskapelle Berlin dhe Orkestrën Konzerthaus Berlin.

Që nga dhjetori i vitit 2015, është Kornist i Parë i Orkestrës Simfonike WDR të Kolnit.

Merita Rexha TERSHANA është një nga pianistet më aktive në skenën muzikore shqiptare. Ajo përfundoi studimet e larta në klasën e prof. Margarita Kristidhi në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas ka ndjekur disa kurse pasuniversitare në Gjermani me profesorë të njohur si Paul Badura-Skoda, Till Engel, etj. Ka luajtur si soliste me orkestrat e Radio Television Shqiptar, Teatrit të Operas e Baletit, Filarmoninë e Tiranës dhe Kosovës etj. Ka marrë pjesë e ftuar në festival prestigjioze si soliste dhe në asamble të muzikës së dhomës, si në Schleswig Holstein Musik Festival në Gjermani, Bregenz Festspiel në Austri, etj. Është e ftuar prej shumë vitesh në festivalet më prestigjioze të rajonit si në Festivalin ReMusica në Kosovë, Ohrid Summer Festival, Pianodrom, Festivalin ndërkombëtar I muzikës së dhomës dhe vitin e fundit në Different trains Festival dhe Ballkan contemporary music festival. Ka interpretuar në vende të ndryshme si Gjermani, Austri, Japoni, Danimarkë, Zvicër, Itali, Greqi, Maqedoni, etj. Ka bashkëpunuar me instrumentistë të njohur si Klaidi Sahatçi, Ermir Abeshi, Areta Zhulla, Thomas Leleu etj. Në vitin 2009 ka regjistruar një cd me vepra të Schumann-it. Në Shqipëri është fituese e shume çmimeve, ndër to fituese dy herë e çmimit Kult si Interpretuesja më e mirë e vitit. Punon në Universitetin e Arteve në Tiranë dhe që nga si pedagoge në Katedrën e Pianos. Ka titullin Profesor i Asociuar që prej vitit 2007.



21:00 Kisha Katolike Shën Ndou

SKENA E RE

ANSAMBLI VOKAL ATTACCA

Hajrullah SYLA dirigjent

Selami Kolonja

Varfëria *(premierë)*

Joseph M. Martin

The Mermaid's Lament

për kor të femrave SSA dhe piano

Kushtrim Gashi

O e Bukura More *(premierë)*

për kor miks dhe piano

Melos Buza piano

Jacobus Gallus

Que mihi crude dolor tantum dominare

për dy kore

Grupi i parë : Kujtesa Nimanaj soprano | Sidorela Kelmend alt | Arbnor Gashi tenor |

Shqipërim Isufi *bas*

Grupi i dytë: Rina Gashi soprano | Adelina Haxhani alt | Agon Tufa tenor | Dritëro

Kelmendi *bas*

Korab Shaqiri

Po shkon çika *(premierë)*

Walte Strauss

Divane askı gibi

Lorenc Antoni

Mirë mbrema | Of, Xhemile

Çesk Zadeja (20 vjetori i vdekjes)

Rritu moj bajame

Në koncertin tematik “**SKENA E RE**” sivjet prezentohet Ansambli Vokal 'Attacca'. Të përkujtojmë se ky segment i festivalit (që ne më parë e quanim 'Podiumi i hapur'), i dedikohet artistëve të rinj, (kompozitorëve dhe instrumentistëve të rinj vendas) është pjesë e pandashme e REMUSICA-s. Në të hapat e parë si krijues i kanë bërë e tërë plejada e re e artistëve të talentuar kosovarë, në radhë të parë kompozitorët e rinj. Kësaj rradhe 'Remusica' i krijon hapësirë një ansambli, i cili, në vitet e fundit po tërheqë vemendjen për organizimi të mirë dhe paraqitje ambicioze, falë punës dhe përkushtimit të udhëheqësit dhe themeluesit të tij, Hajrullah Sylës. Pa mëdyshje, karakteristike më e mirë e programit të tyre së sivjemë është përfshirja e veprave të kompozitorëve vendas. Ansambli vokal ATTACCA është themeluar në vitin 2012, me iniciativë të kompozitorit dhe dirigjentit Hajrullah Sylë. Ky ansambël përbëhet nga 16 koristë profesionist dhe korepetitor.



20:00 Atelieja e Pallatit të Rinisë
ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS
Přemysl VOJTA kornë
Fernando BRIONES dirigjent

Ardian Halimi
“Muzikë për 14 muzikantë”
(Në kujtim të Igor Stravinsky-t)
për ansambël kamertal

Joseph Haydn
Koncert për korno Nr. 1 në D-dur, Hob.VIId:3
Allegro
Adagio
Allegro

Joseph Haydn (Michael Haydn)
Koncert për korno Nr. 2 në D-dur, Hob.VIId:4
Allegro moderato
Adagio
Allegro

Modest Mussorgsky
Pictures at an Exhibition

Koncert në bashkëpunim me Filharmoninë e Kosovës.

Fernando BRIONES nisi studimet në muzikë në Konservatorin Superior të La Korunjës me Rodolfo García Alonso, për kitarë klasike. Briones po ashtu studioi kompozimin me Jose M^a Benavente dhe dirigjimin me Lutz Köhler dhe Salvador Brotons duke diplomuar me notë të lartë. I përfundoi studimet për dirigjim koral me Maite Oca, Juan Luis Martínez, Josep Ramón Gil-Tarrega, Lluís Vila Casañas, David Beaven, Javi Busto, Johan Djuick, Laslo Heltay dhe Martin Schmidt ndërsa ato për dirigjim orkestral me Salvador Mas Conde dhe Jörg Bierhance në Konservatorin e Universitetit të Vjenës. Aktualisht është dirigjent kryesor i Korit dhe Orkestrës “Gaos” që nga themelimi i këtij institucioni në vitin 2009 dhe zhvillon një aktivitet të ngjeshur koncertal duke punuar me një numër të madh solistësh si: Cristina Gallardo-Domas, Ainhoa Arteta, Borja Quiza etj. Është laureat i çmimit të parë të Garës së 13-të Kombëtare të Koreve “Antonio José” në Burgos të Spanjës, fitues i çmimit të dytë i Garës së 32-të Ndërkombëtare “Vila de Avilés” (Spanjë) dhe Garës së 45-të Ndërkombëtare në Ejea de los Caballeros (Spanjë).

Ai udheheqi si dirigjent ndër të tjera Orkestrën e Filharmonisë së Taipei-t dhe Orkestrës Kineze të Taipei-t, Orkestrën Filharmonike tëPontevedra-spër. Përveç aktivitetit koncertal ai është profesor i dirigjimit në Konservatorin Superior të Muzikës në La Korunja të Spanjës.

Přemysl VOJTA është fitues i shumë çmimeve të ndryshme ndërkombëtare. Ai fitoi çmimin e Parë në garën Ndërkombëtare ARD (gara ndërkombëtare e muzikës klasike me e rëndësishme në Gjermani) më 2010. Poashtu pranoi çmimin e Publikut dhe çmimin për Performancën më të mirë për vepër të re ashtu si dhe çmimin e veçantë nga New Philharmonie Westfalen. Në vitin 2011, pas debutimit të suksesshëm në Beethoven Festival Bonn, pranoi çmimin prestigjioz Beethoven Ring.

Přemysli lindi më 1983 në Brno (Republika Çeke), ndërsa ushtrimet në korno nisi në moshën dhjetë vjeçare nën mbiqkyrjen e Olga Voldánová. Pas studimeve në Konservatorin e Pragës me Bedřich Tylšar, u shpërngul në Gjermani ku ishte student i Christian-Friederich Dallmann në Universität der Künste Berlin, nga viti 2004 gjer më 2010.

Tani është ligjerues në Hochschule für Musik und Tanz të Kolnit. Aktualisht është i angazhuar si solist në Akademinë e St Martin në Fields, në Radion e Orkestrës Simfonike Bavareze, Radio Orkestrën e Shtutgartit, në Orkestrën Konzerthaus të Berlinit, Orkestrën shtetërore të Wiesbaden dhe Filharmoninë e Pragës. Performoi në recitale dhe solo koncerte në festivale Europiane me nëm, përfshirë këtu Beethoven Festival në Bon, Prague Spring, Festivalin Mitte Europa dhe Mount Olympus Festival në Shën Petersburg.

Si student Přemysl Vojta ishte anëtar i Orkestrës Rinore Gustav Mahler dhe Orkestrës Rinore të Bashkimit Europian, si dhe performoi me Filharmoninë e Pragës. Kishte pozitën e kornistit të parë në Staatskapelle Berlin dhe Orkestrën Konzerthaus Berlin.

Që nga dhjetori i vitit 2015, është Kornist i Parë i Orkestrës Simfonike WDR të Kolnit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



Kingdom of the Netherlands



KINGDOM OF BELGIUM

www.diplomatie.belgium.be



Liberté • Égalité • Fraternité
RÉPUBLIQUE FRANÇAISE
AMBASSADE DE FRANCE AU KOSOVO



EKIPI I FESTIVALIT / FESTIVAL TEAM 2017

Drejtoreshë e Festivalit/ Festival Director

Donika Rudi

Produktion / Production

Viktor Berishaj

Konsulent i Programit / Programme Consultant

Manfredo Gambino

Koordinatorë / Coordinators

Kushtrim Gashi, Hajrullah Sylja

Menaxhmenti organizativ / Organisational Management

Vesa Jashari, Aida Sopi

Marketing dhe zhvillim i publikut / Marketing and audience

Diana Toska

Menaxhimi i mysafirëve / Guest Management

Dea Xhemaili

Logjistikë / Logistics

Agon Tufa

Audio Sound engineer

Labinot Rudi

Dizajnere e Festivalit ReMusica / Design

Ilire Lepaja

Fotograf i Festivalit ReMusica / Photography

Arben Llapashtica

Vullnetarët / Volunteers

Blenda Konxheli, Rea Xhemaili, Eranda Bokshi, Zanë Abazi, Jon Kursani,
Vjosa Fusha, Rita Zhubi, Lekë Demjaha, Jora Kusani, Elit Hoti, Elena Ukelli, Floriana Rexhepi
Jon Raci, Benit Avdyli, Hana Jashari

Festivali u themelua nga / Festival was founded by

Kosovar Center for New Music KCNM

(Member of ECPNM – European Conference of Promoters of New Music)

President: Rafet RUDI



Partnerët

Kisha Katolike Shën Ndou, Filharmonia e Kosovës / Kosova Philharmonics
Qendra Multimedia

Atelieja e Pallatit të Rinisë



Kisha Katolike "Shën Ndou"



Qendra Multimedia

